



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Numri i lëndës: 2022:087415

Datë: 05.09.2024

Numri i dokumentit: 06126079

**K.DH.SH.II.nr.1479/24**

**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË** - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Dren Rugova dhe Ramush Bardiqi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit të masës së sigurimit “K...C...” Sh.p.k me seli në Prizren, rr. “...” nr.494, me NUI: ... të cilën e përfaqëson D.N. avokat nga Prishtina sipas autorizimit, ndaj kundërpropozuesi i masës së sigurimit “R...” Sh.p.k me seli në Rahovec, rr. “...” p.n, me NUI; ..., të cilin e përfaqëson avokat Ruzhdi Berisha nga Prizreni, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të masës së sigurisë, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë KE.nr.1862/22 e dates; 28.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën; 04.09.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

APROVOHET si e bazuar ankesa e të paditësit-propozuesi të masës së sigurisë “K...C...” Sh.p.k me seli në Prizren, rr.“...” nr.494, me NUI: ..., ndërsa Anullohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë KE.nr. 1862/22 e dates; 28.05.2024, dhe lënda i kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar KE.nr. 1862/22 e dates; 28.05.2024, ka vendosur si në vijim;

“Refuzohet në tërësi si i pabazuar propozimi i propozuesit të sigurimit “K...C...” SH.P.K, me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e sigurimit dhe të i ndalohet kundërshtarit të masës së sigurimit “R...” SH.P.K, që këtij të fundit t’i përmbushet kërkesa, si dhe ndalimi i kundërshtarit të sigurimit të realizoj kërkesën sipas Kontratës noteriale për shfrytëzimin e patundshmërisë me qira LRP.nr. 2611/2021, Ref.nr.518/2021 të datës 29.03.2021, pranë noterit Besim Luli në Prizren, ashtu që kjo kontratë nuk do të prodhoj efekte juridike deri në përfundimin e çështjes kontestimore.”

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë propozuesi i sigurimit, për shkak të shkeljës së dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjës faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovet si e bazuar ndërsa aktvendimin e ankimuar të ndryshohet dhe të caktohet masa siguris ose lënda të priset ashtu që çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqit e paditura me propozim që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit dhe të vërtetohet aktvendimi i ankimuar.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e ankimuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208, ka gjetur se:

Ankesa është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesi i sigurimit “K...C...” Sh.p.k me seli në Prizren në Gjykatës së Shkallës së parë , ka paraqitur padi dhe propozimin për caktimin e masës së sigurimit, kundër kundërshtarit të sigurimit “R...” Sh.p.k me seli në Rahovec, me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e sigurisë ashtu që t’i ndalohet kundërshtarit të masës së sigurimit “R...” SH.P.K, që këtij të fundit t’i përmbushet kërkesa, si dhe ndalimi i kundërshtarit të sigurimit të realizoj kërkesën sipas Kontratës noteriale për shfrytëzimin e patundshmërisë me qira LRP.nr. 2611/2021, Ref.nr.518/2021 të datës 29.03.2021 pranë noterit Besim Luli në Prizren, ashtu që kjo kontratë nuk do të prodhoj efekte juridike deri në përfundimin e çështjes kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me propozimin për caktimin e masës së siguris ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe pretendimet nga ndërgjyqësit në seancën ndëgjimore të datës 24.05.2024,sa i përket bazueshmërisë së propozimit dhe ka marr aktvendimin e ankimuar me arsyetim se nuk është plotësuar anjëra nga kushtet në mënyrë kumulative të parpara në nenin 297 par 1 pika a) dhe b) të LPK-së, sepse propozuesi për caktimin e masës së sigurimit është paraqitur për ndalimin e realizimit të kërkesës të kundërshtarit të sigurimit sipas Kontratës noteriale për shfrytëzimin e patundshmërisë me qira LRP.nr. 2611/2021, Ref.nr.518/2021 të datës 29.03.2021, pranë noterit Besim Luli në Prizren, ashtu që kjo kontratë të mos prodhoj efekte juridike deri në përfundimin e çështjes kontestimore. Ndër të tjera ka theksuar se në rastin konkret kërkesa e propozuesit të masës së sigurisë është paraqitur lidhur me ndalimin e realizimit të të drejtave të kundërshtarit të sigurimit në procedurën përmbarimore, dhe si e tillë nuk gjen mbështetje ligjore, për faktin se sipas ligjit për procedurën përmbarimore, është përcaktuar e drejta e paraqitjes së mjetit juridik përkatësisht prapësimi ndaj urdhërit përmbarimor si dhe kërkesa për shtyrje apo pezullimin e procedurës përmbarimore, e po ashtu edhe e drejta e ankesës ndaj vendimeve të dhëna nga gjykata e shkallës së parë në procedurën përmbarimore, mirëpo me asnjë dispozitë ligjore nuk është përcaktuar e drejta e paraqitjes së masave të sigurimit për dalimin e realizimit të kërkesave të cilat janë objekt shqyrtimi në një procedurë tjetër, në këtë rast në procedurën përmbarimore, respektivisht kërkesa për caktimin e masës së sigurimit nuk mund të paraqiten si mjete të goditjes ndaj dokumenteve në bazë të të cilave është duke u zhvilluar procedura përmbarimore, andaj si rrjedhoj një kërkesë e tillë nuk mund sigurohet në këtë procedurë.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së nuk mund ta pranojë tani për tani një qëndrim të tillë të gjykatës së shkallës së parë nga shkak se aktvendimi i ankimuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 dhe 182 par. 2 pika n), ngase shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore qëndron në faktin se arsyetimi i aktvendimit të ankimuar nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare për marrjen e një aktvendimi të ligjshëm, ndërsa arsyet e dhëna janë të paqarta, kurse lidhur me faktet vendimtare eksitojnë kundërrënie midis asaj që thuhet në arsyet e aktvendimit dhe përmbajtës së propozimit për caktimin e masës së sigurisë dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës.

Në arsyetimin e aktvendimit të ankimuar dhoma e shkallës së parë ka aplikuar dispozitat e nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së pavarësisht përshkrimit të detajuar të procedurës së zhvilluar

dhe deklarimeve të palëve, nuk ka vlerësuar fare nenin 299 par 1 pika c) të LPK-së ngase propozimi për caktimin e masës së sigurisë është drejtuar në kuptim të nenit të lartë cekur, dhe nuk është dhënë sqarim se propozimi i masës së sigurisë a ka mbështetje në nenin 299 par 1 pika c), kurse në arsyetim të aktvendimit të ankimuar flitet për dalimin e realizimit të kërkesave të cilat janë objekt shqyrtimi në procedurën përbarimore, ndërsa në mënyrë se si është propozuar propozimi për caktimin e masës së sigurisë del se propozuesi ka kërkuar që nga kundërshtari i sigurimit të ndalohet realizimi i kërkesave që rrjedhin nga kontrata e qirasë, andaj për kolegjin e kësaj gjykate është e paqartë se qka kërkohet saktësisht me propozim për skatimin e masës së sigurisë e po ashtu e pa qartë është edhe arsyetimi i aktvendimit të ankimor. Kështu, kolegji i kësaj gjykate vlerësoj se Gjykata e Shkallës së Parë, ka marrë aktvendimin e ankimuar i cili nuk përmbanë arsye bindëse repsektivisht nuk përmban fare arsyetim lidhur me pretendimet e propozuesit të masës së sigurisë, po ashtu nuk është sqaruar qartë se një propozim i till a ka mbështetje në nenin 299 par 1 pika c) të LPK-së.

Andaj, në riprocedurë gjykata e shkallës së parë fillimisht ti vlerësoj të gjeturat nga kolegji si dhe ti vlerësoj dhe të analizoj edhe njëher propozimin për caktimin e masës së sigurisë ti këtë parasysh të gjitha pretendimet e palëve në këtë fazë të procedurës, dhe pastaj varësisht nga vlerësimi i provave në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ashtu që lidhur me masën e propozuar të vendos drejt dhe sipas Ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë**

K.DH.SH.II.nr.1479/24 të datës; 04.09.2024

Gjyqtarja  
Franciska Zhitija Ymeri